

UNË E NJOHË ZOTIA TIM



AbdulMexhid Ez-Zendani

Unë e njoha Zotin tim

AbdulMexhid Ez-Zendani

Tiranë 2005

<http://www.jetaever8.de/>

**Shqipëroi: Altin Torba
(me ndërhyrje të lehtë)**

**Kopertina:
Eduart Thartori**

**Botues:
Alfred Ziu**

Tiranë 2005

Pasqyra e lëndës:

- 1. Dilema e madhe e vogël:.....f -10-**
 - A duhet patjetër ta ketë krijuar dikush Krijuesin e gjithësisë?!.....f -11-
 - Cilësitë e Krijuesit ndryshojnë thelbësishë nga cilësitë e krijesave.....f -16-
 - Ateistët mosbesimtarë ngurruan t'ia mveshnin cilësinë e përhershëmërisë Krijuesit, mirëpo nuk ngurruan t'ia mveshnin atë materies... por sa qëndron kjo bindje e ateistëve?.....f -24-
- 2. Njohja e emrave dhe cilësive të Allahut..f -31-**
 - Rëndësia e njohjes dhe mësimit të cilësive të Allahut të Lartësuar.....f -32-
 - Cilësitë e larta, të plota dhe të përsosura i takojnë vetëm Allahut.....f -35-
 - Cilësitë e Allahut të Lartësuar janë të përsosura dhe të shumta në numër.....f -36-
 - Cilësitë e mahnitshme tek krijesat janë një shembull i gjallë përmenyrën se si duhet t'i kuptojmë cilësitë e përsosura të Allahut.....f -38-
 - Si të arrijmë t'i mësojmë cilësitë e Allahut të Lartësuar:.....f -40-
 - Injorancë që shpie në humbje.....f -43-
 - Mendja dhe mesazhi hyjnor.....f -46-
 - Mendja dhe imagjinata.....f -48-
 - Forca imagjinuese dhe kufizimi i saj me pesë shqisat.....f -53-
 - Cilësitë dhe emrat e bukur e të përsosur të Allahut.....f -56-

Hyrje:

“Kur një pikëlzi iji e kulluar avullon nga oqeani, pikëlzat e tjera të oqeanit mendojnë se për të ky është fundi, porse në të vërtetë ajo gjendet lartë në qiell... E pikëlzat e tjera të oqeanit nuk munden ta mësojnë këtë të vërtetë, vetëm se pasi t’i nënshtronë të njëjtë udhëtim që kjo pikëlzi ka përshkuar.”

Shkëputur nga filmi “Oktapodi”

Njeriu i mençur vëren qartazi sesi gazetaria dhe media “goja dhe syri i botës” që posedohen nga njerëz me zemra dhe interesa të ngushta, nuk bëjnë gjë tjetër veçse vjellin parreshtur mosbesimin, shthurjen dhe frikën.

Vjellin mosbesimin nën moton “shijo momentin” dhe “shfrytëzoje këtë botë” me çdo lloj mënyre e mos çaj kokë për ekzistencën e botës së përtejme të përgjegjësimit, gjykimit dhe shpërblimit.

Vjellin shthurjen, lakuriqësinë dhe degjenerimin nën moton “femra moderne dhe arti”, kësaj shthurjeje totale apo të pjesëshme që dikush ndoshta me të drejtë e ka quajtur “tregëtia e mishit të bardhë”; vjellin shthurjen, lakuriqësinë dhe degjenerimin nën moton “modernizim dhe qytetërim” ku në fakt sundon mafia, narkotizmi, shthurja dhe shfrenimi me të gjitha trajtat e tyre.

Vjellin frikën nga mafia, krimi, kërcënimi dhe pasiguria që në të shumtën e rasteve; si në servirjet kinematografike ashtu edhe në ato të jetës së përditëshme; vishen me rrobën e organeve më të larta të drejtësisë, policisë dhe hetuesisë.

Pikërisht në brendi të kësaj piramide të errët trekëndore “mosbesim-shthurje-frikë” me bazë

ateizmin është robëruar pa vetëdije çdo njeri që nuk beson. Sepse nuk i ngelet tjetër njeriut përveçse të besojë ose të bjerë viktimë e humbjes, kotësisë, shthurjes dhe frikës që propagandohen 24 orë -non stop- në skenarin e realitetit të errët të shoqërisë ateiste bashkëkohore dhe në skenarin dashakeq dhe të kurdisur të medias elektronike dhe asaj të shkruar...

- Onjerëz të mençur! A mos prisni nga kjo errësirë t'ju udhëzojë për tek drita...

A nuk më jepni të drejtë që të pyes se edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

Të ngelet injorant edhe pse mund të jetë nga kokat më të mençura të filozofisë dhe mendimit...

Filozofi dhe mendimtari me famë botërore Alekses Karel, edhe pse nga krerët e padiskutueshëm të filozofisë botërore, nëpërmjet titullit të librit të tij të famshëm "Njeriu. Ky mister i madh", shpreh qartazi hezitimin e tij në lidhje me pse-në e ekzistencës së njeriut.

Kurse poeti ateist nxjerr në pah hezitimin e tij në lidhje me pse-në e ekzistencës së tij nëpërmjet vjershës së tij të shumënjohnur ku thotë:

"Erdha... Nuk e di se nga, porse di që erdha.

Pashë para meje rrugë dhe mbi të unë eca.

E do të ngelem duke ecur desha apo nuk desha.

Nga erdha? Nuk e di.

Pse erdha? Nuk e di.

Përse nuk e di? Nuk e di..."

- Edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

"Qytetërimi" modern i ka mësuar njeriut si të hajë bukur, si të flasë bukur, si të vishet bukur, si të sillet bukur..., porse nuk ka arritur t'i mësojë njeriut

gjënë më kryesore, se përse njeriu i bën gjithë këto gjëra, përse jeton...

- Edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

A nuk e di njeriu se ajo që shkatërron çdo kënaqësi, ëndërr dhe ambicie, vdekja, mund ta befasojë atë nga njëri çast në tjetrin?!

- Edhe për sa kohë do të vazhdoshë të ngelesh o njeri injoranti më i madh në lidhje me vetveten tënde...?!

Çfarë pret o njeri?!

A mos pret ndonjë tërmet si ai i Lisbonës në Portugali që në pakçaste u mori jetën mbi shtatëdhjetë mijë vetëve? Apo si ai i Kinës që në pak minuta u mori jetën mbi tre milion vetëve? Apo pret ndonjë aksident që mund të të befasojë në çdo moment? Apo pret infarktin të të marrë në krahët e tij të zi e të të nxjerrë nga kjo jetë edhe pse pa shkak të prekshëm shëndetësor? Apo...? Hë pra, a pret vdekjen të të nxjerrë nga kjo botë e ta lësh atë si të mos kesh ekzistuar kurrë më parë?

- Edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

Ja! Sot mbi shtyllat e qytetit janë afishuar ca njoftime...

Dikush afrohet t'i lexojë...

Po, po! Këto njoftime bëjnë fjalë pikërisht për ty, bëjnë fjalë për vdekjen tënde...

Dikur vetëm kishe dëgjuar për të vdekurit, kurse sot je një prej tyre...

Dikur vetëm i kishe vizituar e soditur varrezat, kurse sot je një prej banorëve të tyre...

Dikur përpinqeshe në hallall ose haram që ta ushqjeje trupin tënd, kurse sot trupi yt është bërë ushqim për krimbat e tokës...

Dikur ecje mbi tokë me krenari dhe mburrje, kurse sot gjendesh i téri brenda barkut të tokës...

Ja! Tashmë në mizérinë e varrezave edhe një varri i ri... Ndër banorët e varrezave edhe një banor i ri...

Dikush afrohet të lexojë emrin mbi pllakadën e ftohtë të këtij varri... Lexon mbi të emrin tënd... Datën e befasishme të vdekjes tënde që të mori dhe të nxorri nga kjo botë pa të kërkuar leje aspak...

Dikush teksa ecën i struktur nën rrobën e tij të ngrohtë i hedh sytë e tij rrëmbimthi nga varrezat dhe i mëshiron këta banorë të varreve të ngushta që dikur ndoshta jetuan në vilat dhe çifligjet e gjëra... dhe harron ky i gjorë se një ditë edhe ai do të rradhitet në rradhët e tyre.

- Edhe për sa kohë do të vazhdoshë të ngelesh o njeri injoranti më i madh në lidhje me vetveten tënde...?!

A nuk e dëgjove vjershëtorin që nëpërmjet varjeve të tij të qëllimita u përcjell mesazhin e tij njerëzve të mençur:

*“Një ditë unë vizitova varrezat
dhe mbi pllakadat e ftohta shumë data unë pashë.
Ja! Mbi këtë varr të vogël lexoj një mbishkrim
që tregon se banor i këtij varri të vogël,
është një foshnje që vdiq
pa dalë ende nga barku i nënës.*

*Kurse këtu më tej, mbi këtë pllakadë varri
është vizatuar një trëndafil i këputur
dhe poshtë tij është shkruar “Kujtim nga
familja”, një mbishkrim,*

*familja që shumë e donte djalin e saj
ka lënë pér tē, thjeshtë këtë kujtim.
Ec edhe më tej. Një plak ka vdekur,
grua, burrë apo fëmijë.
Ja edhe varri i një djali tē ri!
Dikur e kam njojur këtë njeri.
Mbi pllakadën e varrit ish e fejuara e tij
-që tashmë është martuar- pati lënë një
mbishkrim,
e tashmë pér tē, ish i fejuari i saj, s'ka ngelur
veçse një vegim,
një vegim mendimesh që rrallë herë shkrepëtin...
E pas vdekjes ai që tē deshi më së tepërmi
a e di se kush është nderimi më i madh që do tē
bëjë?
Ca lopata dhé më tepér, konkurs kush e kush më
parë tē tē mbulojë...
Banorë tē varreve tē ngushta
që dikur jetuan në këtë botë tē gjerë,
lindën, jetuan, dhe vdekja i transferoi
në Botën Tjetër, në pérjetësi, në amshim
atje ku i pret shpërblim ose ndëshkim.
Sa keq që shumë prej këtyre njerëzve lindën,
jetuan, dhe dolën nga kjo jetë e shkretë,
pa ditur pér ekzistencën e tyre asnë qëllim... ”*

*- Edhe pér sa kohë do tē vazhdosh tē ngelesh o
njeri injoranti më i madh në lidhje me vetveten
tënde...?!*

*- Pér këtë shkak zgjodhëm këtë material tē
zgjedhur që lusim Zotin tē shërbajë si një derë e vogël
hyrje pér në kaltërsitë dhe horizontet e pérjetëshme tē
besimit.*

(Altin Abdullah Torba)

Me emrin e Allahut! Mëshiruesit!

Mëshirëbërësit!

“...Asgjë nuk i ngjan Atij -Allahut-. Ai është Dëgjuesi dhe Vështruesi.”¹

1)Dilema e madhe e vogël:

Përgjigja ndaj atij që në injorancë të plotë thotë: “Përderisa çdo gjëje për të ardhur në ekzistencë i duhet një krijues, atëherë edhe vetë Krijuesin duhet që dikush ta ketë krijuar.”

- Në fakt, njeriu ateist arriti tek ky supozim pasi u bazua në parimin logjik se: “Asnjë kriesë nuk mund të vijë në ekzistencë pa një krijues dhe ashtu siç asnjë kriesë nuk mund të vijë në ekzistencë pa një krijues, ashtu edhe Krijuesi i gjithësisë nuk mund të ketë ardhur në ekzistencë pa një krijues”...

Pra bazohet në parimin “ashtu siç, ashtu edhe”. E ky parim logjik dihet mirë se ka vlerë vetëm për gjërat e njëjtë, me cilësi e karakteristika të njëjtë. Por a janë në fakt cilësitetë dhe karakteristikat e Krijuesit si ato të kriesës?!

Në realitet, ky supozim i ngritur mbi një parim të gabuar, patjetër që është një supozim i gabuar.

Por sidoqoftë le ta analizojmë së bashku këtë dilemë të ateistëve për të cilën vetë profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na ka lajmëruar se do të vijë dita kur ajo do t'i kapërcejë gojët dhe mendjet dashakeqe djallëzore, për të sulmuar zemrat dhe mendjet e pastra njerëzore...

¹ Marrë nga thënia Kuranore nr. 11 në kaptinën Kuranore “Esh-Shura-Konsulta”

A duhet patjetër që ta ketë krijuar dikush Krijuesin e gjithësisë?!

Pyetja në fjalë është një pyetje e gabuar përderisa ajo ngrihet mbi bazën e barazisë, ngjashmërisë dhe krahasimit ndërmjet Krijuesit dhe krijesave të Tij. Dy ekzistencave që janë thelbësish të ndryshme në cilësitë dhe veçoritë e tyre.

Kjo gjë kuptohet fare qartë nga çdo njeri që ka një logjikë të shëndoshë.

Cilësitë që duhet të posedojë Krijuesi i Lartësuar duhet patjetër që të ndryshojnë nga cilësitë e krijesave të Tij, sepse përndryshe nuk do të kishte asnjë ndryshim dhe dallim në mes tyre dhe do të ishin një gjë e vetme.

Kështu pra, ai që shtron këtë supozim e ka rradhitur Krijuesin në të njëjtën rradhë me krijesat, përderisa ka bërë si cilësi të domosdoshme për Të që të ketë një krijues.

Por dihet mirë se çdo kriesë -qoftë ajo në qiell apo në tokë- në detaj ndryshon nga çdo kriesë tjetër. Sidomos ky ndryshim mes krijesave është shumë më i madh dhe më i spikatur kur këto kriesa janë specie të ndryshme dhe i përkasin llojeve e natyrave të ndryshme...

Ne, me ndryshim të tyre nënkuptojmë ndryshimin në cilësitë, karakteristikat dhe ligjësitë ekzistenciale të këtyre krijesave.

Nëse nuk do të ishte ky ndryshim atëherë të gjitha krijesat do të ishin një...

Pra guri, druri, njeriu, kafsha, uji, dheu, ajri, zjarri etj, do të ishin një gjë e vetme.

Përderisa kriesat në mes tyre ndryshojnë nga njëra-tjetra në cilësitë, karakteristikat dhe ligjësitë ekzistenciale të tyre, atëherë nuk ka dyshim në faktin se, për më tepër, edhe Krijuesi i tyre ndryshon nga kriesat e Tij të cilat i solli në këtë ekzistencë dhe i pajisi me cilësitë, karakteristikat dhe ligjësitë ekzistenciale që vetë Ai deshi.

Për Allahun janë cilësitë, karakteristikat, veprimet dhe ekzistimi hyjnor ku kurrë nuk mund të depërtojë mendja e kufizuar dhe e kushtëzuar e njeriut.

Pikërisht për këtë realitet bën fjalë Kurani Fisnik kur njofton se:

“...Asgjë nuk i ngjan Atij -Allahut-...”

Esh-Shura-Konsulta (11)

- Dihet shumë mirë se njeriu është ai që ka prodhuar dhe bërë shumë prej sendeve dhe orendive që na rrëthojnë, porse a janë cilësitë e njeriut si cilësitë e këtyre sendeve dhe orendive?!

Kështu, nëse shikojmë një karrige të vendosur imbi një tavolinë apo diku tjetër, me të drejtë mund të mendojmë se dikush e ka lëvizur atë.

Por a është e drejtë për ne që, kur ta shohim njeriun të ketë lëvizur nga një vend në tjetrin, të mendojmë ashtu siç menduam për karrigen, dhe të themi se, ashtu si për karrigen -këtë vepër të njeriut-, ashtu edhe për njeriun, që të lëvizë nga një vend në tjetrin, duhet patjetër dikush që ta lëvizë atë?!...

A është e drejtë të themi se cilësia dhe karakteristika e veprës duhet të jetë patjetër cilësi dhe karakteristikë edhe për bërësin e saj? Se cilësia dhe karakteristika e kriesës duhet të jetë patjetër cilësi dhe karakteristikë edhe për Krijuesin e saj?!...

Çfarë qëndrimi do duhej të mbanim kundrejt një personi i cili mohon që njeriu të ketë mendje dhe logjikë duke përdorur si argument për këtë veprat e njeriut që nuk kanë mendje dhe logjikë?!

S'ka dyshim se çdo njeri i arsyeshëm, këtij personi do t'i thoshte: "O filan! Cilësitë dhe veçoritë e njeriut ndryshojnë nga cilësitë dhe veçoritë e veprave të tij..."

Të gjitha krijesat ndryshojnë nga njëra-tjetra, sidomos kur ato u përkasin llojeve të ndryshme.

Nisur nga këtu, mund të kuptohet fare qartë fakti se cilësitë e Krijuesit dhe Vetvetja e Tij Hyjnore ndryshojnë me ato të krijesave, përfshirë këtu edhe njerëzit...

- E megjithë sa përmendëm më lartë, djalli, nëpërmjet gojëve të liga të njerëzve të paskrupullt e injorantë, tenton t'i ngacmojë dhe luhatë mendjet e njerëzve të paditur dhe të dobët, deri edhe me pyetjen e pavend, se: **Kush e krijoi Krijuesin e krijesave??**

Siç e përmendëm, askush nuk ka dyshim në faktin se, Krijuesi nuk është si krijesat e Tij të cilat i krijoi dhe i nënshtroi si deshi, ashtu sikurse edhe njeriu, nuk është si veprat e bëra prej tij -e për Allahun është shembulli më i lartë-.

Kështu, ne e dimë që nga cilësitë e krijesave është se krijesës i duhet patjetër që të ketë një krijues, por kjo nuk do të thotë që edhe për Krijuesin duhet patjetër të ketë një krijues, sepse siç thamë më lartë, Krijuesi nuk është si krijesat e Tij.

Cilësitë e Krijuesit të gjithësisë duhet medoemos të ndryshojnë nga cilësitë e krijesave të Tij...

Cilësitë që ka Krijuesi i Lartësuar janë të plota dhe të përsosura, ndryshtë nga cilësitë e mbarë krijesave.

Në cilësitë e Krijuesit nuk ka vend për cilësi që e bëjnë Atë të nevojshëm për dikë apo diçka.

Në fakt është qesharake, porse ai që barazon cilësitë e Krijuesit me cilësitë e krijesave gabon rëndë, ashtu siç gabon rëndë ai që barazon cilësitë e një marangozi me cilësitë e derës që është vepër e duarve të tij -e për Allahun është shembulli më i lartë-...

Nisur nga fakti në fjalë, pra nëse do të ecim me parimin se: “Çdo cilësi e veprës duhet të jetë edhe cilësi e veperbërësit”, kjo do të thotë se:

Cilësitë e derës = *Cilësitë e marangozit*
Dera prej dërrase ⇒ Marangozi prej dërrase???
Dera e sharruar dhe zdrukthuar ⇒
⇒ Marangozi i sharruar dhe zdrukthuar???
Dera me bravë ⇒ Marangozi me bravë??? etj...
ose e anasjellta:

Cilësitë e marangozit = *Cilësitë e derës*
Marangozi ka nënë e babë ⇒ Dera ka nënë e babë???
Marangozi lëviz, ha, pi... ⇒ Dera lëviz, ha, pi...???
Marangozi martohet ⇒ Dera martohet??? etj...

Kështu në realitet, kushdo që barazon në mes veperbërësit dhe veprës së tij -në rastin tonë në mes marangozit dhe derës-, do të bëhej objekt tallje dhe përcmimi për të tjerët.

Nëse kriesat për të ardhur në këtë ekzistencë patën nevojë për Krijuesin e tyre -për përkujdesjen e të Cilit kanë nevojë të vazhdueshme e të patjetërsueshme gjër në vdekje-, Ai, Krijuesi i tyre, Allahu i Lartësuar, nuk ka nevojë për askënd, ndërkohë që të tjerët kanë nevojë të domosdoshme për Të.²

Cilësitë e Allahut, Zotit tonë, janë cilësi të plota që ndryshojnë nga cilësitë e mangëta të krijesave të Tij.

² Referohu në Kur'an, kaptina El-Ihlas (2).

E në universin e dendur me krijesa, ka dëshmi pafund që gjallërisht hedhin dritë mbi faktin se Krijuesi dhe Sunduesi i këtij universi është i Pavarur, Sovran dhe nuk ka nevojë për askënd.

Cilësitë e Krijuesit ndryshojnë thelbësisht nga cilësitë e krijesave:

- Krijuesi është i Përjetshmi, që solli në këtë ekzistencë çdo gjë nga asgjëja.

Mbarë universi, nga përbërësi më elementar i tij e deri tek ai më gjigand, dikur nuk ekzistonin dhe ky univers me gjithë sa ka në të, u sollën në këtë ekzistencë vetëm në sajë të dëshirës krijuese të Zotit të Lartësuar.

- Krijuesi është Ligjvënësi, kurse krijesat janë të detyruara që t'i nënshtrohen ligjeve të vendosura sipas dëshirës sovrane të Krijuesit.
- Krijuesi posedon në Vetveten e Tij cilësitë e plota, kurse cilësitë e krijesave janë të mangëta, të nevojshme, të kushtëzuara dhe të kufizuara.

Kurse atcisti kokëfortë e i pabindur, që pas gjithë kësaj vazhdon të këmbëngulë se duhet medoemos që dikush ta ketë krijuar Krijuesin e gjithësisë, me këtë mendim të cekët dhe me këtë injorancë pa fre, ka mohuar edhe ekzistencën e vetvetes bashkë me atë të gjithë krijesave të tjera sepse:

Kush pas Krijuesit të gjithësisë përvëç asgjësë do të ishte Krijuesi i Vërtetë?!

A mund të ketë ardhur ky Krijues prej asgjësë?!

Përderisa asgjëja nuk ekziston, atëherë edhe krijuesi i krijuar prej saj nuk ka sesi të ekzistojë, gjë që do

të thotë se edhe krijesat e krijuara prej këtij krijuesi nuk kanë sesi të ekzistojnë.³

Nëse pas gjithë kësaj ateistët me kokëfortësi këmbëngulin në të tyren, u themi:

Në rast se ecim -Allahu na faltë- me supozimin tuaj ateist, se Krijuesi duhet patjetër që, ashtu si dhe krijesat, të jetë i krijuar, kjo do të thotë se Krijuesi dikur-para se të krijohej- nuk ka ekzistuar dhe si rrjedhojë as krijesat -në mungesë të Krijuesit- nuk kanë ekzistuar.

Pra nuk kanë qenë as Krijuesi dhe as krijesat.

Lind pyetja: **E çfarë ekzistonte atëherë?**

Përgjigjja duhet të jetë: Asgjë nuk ekzistonte. E thënë ndryshe, gjendja në fjalë e ka emërtimin mosekzistencë...

A mos vallë, Krijuesi erdhi nga mosekzistenca?! Po krijesat?!

Asnjë njeri me mend në kokë nuk do ta besonte një gjë të tillë.

Mosekzistenca, që nuk ekziston as përvete, nuk mund të sjellë në ekzistencë asgjë prej gjëje.

Prandaj nuk na ngelet veçse të besojmë se ky Krijues është i Përhershëm dhe në cilësitë e Tij nuk ka vend përvartësi dhe nevojë.

Në fakt, ateistët nuk kanë para tyre përveçse tre alternativa prej të cilave mund të zgjedhin se cila është zanafilla e kësaj ekzistence:

1- A e ka zanafillën kjo ekzistencë nga asgjëja, thënë ndryshe nga mosekzistenca absolute?

Mirpo a mund të krijojë asgjëja -mosekzistenca- që nuk ekziston as përvete?!

³ Me këtë rast i japim një të goditur këtij ateisti e nëse ai ankohet i themi: Si po ankohesh. Një mosekzistencë nuk mund të ankohet..

2- Apo kjo ekzistencë e ka zanafillën nga krijesat, qofshin këto gjallesa apo sende pa jetë, veç e veç apo së bashku?

Por edhe për këtë dihet mirë se ashtu si krijesat e gjalla poashtu edhe sendet pa jetë prej të cilave përbëhet universi ynë, diku nuk kanë ekzistuar në këtë univers⁴ dhe një ditë prej ditësh, herët ose vonë, përsëri do të zhduken...

Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së parashtruar do të marrim një shembull me krijesën e vetme intelegrante, njeriun. A ka krijuar ai gjë prej gjëje në këtë univers?

Përgjigjen do të na e japë vetë fakti se njeriu nuk ka krijuar në vetveten e tij as edhe një qelizë të vetme dhe nuk ka krijuar në tokë as edhe një fije bari. Atëherë si të mund të krijojë ai gjë tjetër nga kjo ekzistencë?!

Njeriu dhe mbarë universi një herë e një kohë nuk kanë ekzistuar, andaj si mund të jenë ata zanafilla e krijimit?!

3- Apo mos ky univers, i sjellur ne ekzistencë prej qindra miliarda vjetësh, e ka zanafillën nga një Ekzistues që ka ekzistuar pëpara tij?

Në fakt kjo është e vëtmja alternativë logjike e pranueshme që mund të shpjegojë ekzistencën faktike të universit dhe mbarë banorëve të tij.

Pikërisht në këtë mënyrë interesante të logjikuari Allahu i Lartësuar i sfidon mosbesimtarët në Kur'anin Fisnik ku në lidhje me këtë gjë thotë:

⁴ Sipas hipotezës shkencore të "Big Bang-Shpërrthimi i madh" që përkrahet nga masa dërrmuese e shkencëtarëve të astronomisë, që thotë se universi ynë në fazën e tij tepër të hershme ishte në madhësinë e një kokrre veze, kurse para kësaj ishte i ndrydhur dhe tkurrur në madhësinë e një qindarke. Nëse do të pyesim: Po më parë? Përgjigjja do të jetë nuk ekzistonte.

“A mos u krijuan prej asgjësë, apo ata vetë janë krijues?! A mos ata i krijuan qiejtë edhe tokën?! Jo, por ata nuk janë të bindur.” Et-Tur (35-36)

Kështu pra, njeriut të mençur nuk i ngelet veçse të bindet dhe pranojë se kjo ekzistencë e ka zanafillën nga Krijuesi i Përherëshëm dhe jo nga mosekzistenca.

Pasi shtruam pyetjet e lartpërmendura për zanafillën e universit, le të shtrojmë të njëjtat pyetje edhe për t’iu përgjigjur pyetjes së ateistëve se:

Nga ku e ka zanafillën Krijuesi?

Rrjedhimisht pyetjet do të jenë si vijon:

1- A e ka zanafillën Krijuesi nga asgjëja, thënë ndryshe, nga mosekzistenca absolute?

Përgjigjja: Mosekzistenca që nuk ekziston as përvete nuk mund të sjellë në ekzistencë asnje gjë prej gjëje...

Nëse do të thuhej se një avion është bërë nga një fabrikë e boshatisur kurrsesi nuk do ta besoje, e le më po të të thuhej e njëjta gjë përmendjen inteligjente të njeriut, prodhuesit të avionit...

Nëse asgjëja do të ishte origjina e ekzistencës, atëherë ashtu sikurse asgjëja nuk ekziston ashtu edhe unë, edhe ti, edhe këta rrështa të shkruara dhe çdo gjë tjetër nuk do të ekzistonim.

Fakti në fjalë mund të formulohet në trajtën e mëposhtme:

...asgjëja...**Krijuesi**...asgjëja...

2-Apo Krijuesi e ka zanafillën nga kriesat qofshin ato gjallesa apo sende pa jetë, veç e veç apo së bashku?!

Përgjigjja: Kjo është një pyetje retorike që nuk ka nevojë përmërgjigje.

Kriesat, që përpata se të vinin në këtë ekzistencë nuk ekzistonin, nuk mund të jenë ato që kanë krijuar Krijuesin e tyre i cili ekzistonte para krijimit të tyre.

3- Apo Krijuesi e ka zanafillën nga një ekzistues -krijues- që ka ekzistuar para Tij?

Nëse themi se ky krijues e ka zanafillën nga një krijues tjetër që ka ekzistuar para Tij, atëherë:

Së pari: A mund të jetë Krijuesi Sovran i çdo gjëje, një i krijuar?! Një krijues që e ka zanafillën nga një krijues që ka ekzistuar para tij, nuk është më Krijues por është i krijuar. Në këtë rast i bie që Ai që ka ekzistuar më parë të jetë Krijuesi i Vërtetë, kurse ky i mëvonshmi të jetë një kriesë e krijuar prej Krijuesit të Parë dhe jo Krijuesi i Vërtetë...

Së dyti: Do të na lindë pyetja se: “Po ai tjetri - krijuesi i mëparshëm- nga kush e ka zanafillën? ...

Kështu do të biem viktimit e zinxhirit enigmatik të pafund të “krijuesve të krijuar”, që normalisht nuk mund të ketë për skaje veçse asgjënë

Fakti në fjalë mund të formulohet në trajtën e mëposhtme:

...asgjëja...**krijues** (zanafilla e të cilit është nga një)! **krijues** (që ka ekzistuar më parë, zanafilla e të cilit është nga një)! **krijues** (që ka ekzistuar më parë, zanafilla e të cilit është nga një)!...(që ka ekzistuar më parë, zanafilla e të cilit është nga)! **Krijuesi i Parë**...asgjëja...

Lind pyetja: Kush është Krijuesi më i Parë?!

Sigurisht që do të ketë një krijues që është krijuesi më i Parë sepse origjina e ekzistencës nuk mund të jetë kurrsesi nga asgjëja.

Ai më i pari është Krijuesi i Vërtetë, kurse të gjithë të tjerët janë të krijuar dhe kurrsesi nuk mund të jenë krijuesit e vërtetë.

Në fakt zanafilla e vërtetë ekzistenciale mund të shprehet vetëm duke e korriguar formulimin e mësipërm si më poshtë:...asgjëja...**Krijuesi i Parë**-që nuk ka zanafillë dhe që çdo gjë e krijuar prej Tij është kriesë-...asgjëja...

Njeriut tē mençur nuk i ngelet veçse tē zgjedhē me bindje tē plotē se ky univers me sa bart nē tē s'ka si tē jetē vepēr e asgjēsē -mosekzistencēs-, porse ky univers i përsosur ështē vepēr e Krijuesit tē Vetēm e tē Pérhershēm, qē s'ka dyshim se nuk ka ardhur nga mosekzistenca dhe qē nuk ka ndonjē zanafillē.

Sepse një krijuesi qē do t'i duhej tē vijē nga mosekzistenca kurrē nuk do tē ekzistonte.

Jo vetēm kaq, por as krijesat e Tij atēherē nuk do tē ekzistonin, pra as unē, as ti...

Kurse pēr sa i pērket orvatjes, apo thënē ndryshe pērpjekjes sē mendjes sē kufizuar dhe kushtēzuar njerēzore pēr tē kuptuar dhe konceptuar sekretin e pérhershdmērisē sē Allahut, kjo do tē ngelet një pērpjekje e kotē, pasi njeriu i cili jeton e shumta nē kufijt e një njëqind vjeçari, nuk mundet kurrsesi tē arrijē tē imagjinojē dhe konceptojē pérhershdmērinē...

Por nëse fjala pérhershdméri a pérjetësi, tingëllon e huaj pēr konceptimin njerēzor, atēherē le ta hedhē njeriu vështrimin tek gjallesat qē jetojnë shumë më gjatë se ai, si p.sh. balena, pastaj tek bimët ose pemët, mosha e tē cilave arrin deri nē disa mijëra vjet, pastaj tek yjet, mosha e tē cilëve arrin nē biliarda vjet, gjë qē kundrejt moshës sē shkurtër tē jetës sē njeriut është sikur tē ishte vetë pérjetësia.

Pra Zoti, Krijuesi i këtyre krijesave dhe universit tē lashtë është Ai qē ka ekzistuar nga infiniti i pérhershdmērisë.

Koha është një karakteristikë e materies, madje ndodh qē edhe materia ta sfidojë atë përmiliarda vite.

Dihet mirč se Krijuesi ka ekzistuar pērpara se tē vinte nē këtë ekzistencë dynjaja me ligjet e sajprej tē cilëve është edhe koha.

E pra Krijuesi është i Përhershmi. Është Allahu Ai që e krijoi ligjësinë e kohës në dynja dhe ajo nuk mundet kurrsesi të përbëjë një sfidë për Krijuesin dhe Sunduesin e saj.

Vetë fakti që koha në universin tonë është relative⁵ përbën një argument më vete se ashtu siç ajo mund ta kufizojë jetën e disa gjallesave si bakteriet dhe kandirrat në disa minuta, ditë, javë e maksimumi muaj, e disa të tjerave në dhjetëra vite si gjitarët dhe disa të tjerave në qindra vite si pemët, ashtu ajo mund të zgjatet edhe në kufinjtë e infiniteve jetësore.

Fillimi i kësaj ekzistence patjetër që ka qenë nga dikush që ka ekzistuar në infinit, para saj.

Në një thënie të tij i dërguari i Allahut, Muhamedi - lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na lajmëron

⁵ Një shembull sclarues sesi ligjësitë e Krijuesit në varësi të dëshirës hyjnore sovrane ndryshojnë brenda për brenda një lloj ligjësie e madje mund edhe të eliminohen si ligjësi atëherë kur Krijuesi e do një gjë të tillë, është p.sh. ligji i peshës (forcës së rëndesës ose siç njihet ndryshe forcës tërheqëse -gravitetit-). Dihet mirë se forca tërheqëse -pesha- në Tokë ndryshon nga ajo në Hënë me tre fish më tepër. Pra një njeri që në Tokë mban normalisht 50 kg, në Hënë mund të mbajë normalisht 150 kg... Porsë ligjësia e forcës tërheqëse që dikton peshën e materies, kur do Krijuesi -si në shtresën atmosferike të Tokës ku vendosen satelitët- eliminohet, prandaj neve i kemi parë imazhet mahnitëse që përcjellin kamerat satelitore me kozmonautët që të pavarrur nga ligji i peshës na dhurojnë neve fragmente magjepsëse ngajeta që bëjnë. Kemi parë sesi ata rrrotullohen sipas dëshirës, kemi parë ujin, gotën, pjatën etj, të qëndrojnë pezull në ajër pa u mbështetur gjëkundi... E ashtu siç dëshira hyjnore sovrane ka mundësuar që ligjësia e peshës diku të jetë më e madhe, diku të jetë më e vogël dhe diku të mos ekzistojë fare, ashtu kjo dëshirë hyjnore është krejt e aftë që ligjin e kohës, =

neve për infinitin e përhershëmërisë, para ekzistencës së universit dhe çdo gjëje tjeter, thotë:

"Ishte Allahu dhe nuk ekzistonte asgjë tjeter para Tij... pastaj krijoj qiejtë dhe tokën..."

-Transmetim nga imam Buhariu-

Gjithashtu lexues i dashur, duhet të dish se këto dyshime të cekëta dhe të pabaza djallëzore i hodhën ateistët që në idetë e tyre kanë mendësinë se materia është e përhershme, e pafillim dhe e pambarim...

= pra jetën, diku ta bëjë më të gjatë (si në Pluton për shembull, ku një vit është afersisht sa dyqind e pesëdhjetë vite në Tokë, apo si me rastin e pemëve për shembull, jeta e të cilave mund të arrijë edhe në disa dhjetëra shekuj ndërkohë që jeta e njerëzve arrin maksimumi një shekull), diku ta bëjë ligjin e kohës, pra jetën, më të shkurtër (si në Mërkur për shembull, ku një vit është vetëm sa tetëdhjetë e tetë ditë në Tokë, apo si me rastin e mikrogjallesave për shembull, jeta e të cilave arrin maksimumi në disa orë ndërkohë që jeta e njerëzve mund të arrijë edhe në treth 876 000 orë -100 vjet-) dhe diku ta eliminojë dhe asgjësojë ligjësinë e kohës, gjë që do të thotë përjetësi.

Ateistët mosbesimtarë ngurruan t'ia njohin Krijuesit, cilësinë e përhershëmërësë, porse nuk ngurruan t'ia mveshnin atë materies së universit.

Thanë: Ne nuk mund të besojmë në një Krijues të Përhershëm por besojmë se vetë universi është i përhershëm...

Me këtë donin të mohonin besimin e besimtarit në përhershëminë e Zotit, Krijuesit të universit.

Por sa qëndron kjo bindje e ateistëve?

Së pari: Duhet ditur se shkaku kryesor i daljes në skenë të këtyre hipotezave -teorive të rreme- ishte konflikti i ashpër që ishte ndezur në atë kohë në mes kishës dhe shkencëtarëve të cilët kishin guxuar të publikonin zbulimet e tyre shkencore që binin në kundërshtim të plotë me predikimet e deformatuara të kishës.

Si pasojë kisha, këta pionierë të guximshëm të shkencës së asaj kohe, i persekutoi, keqtrajtoi, madje edhe i asgjësoi me varje, dënim në turrën e druve dhe të tjera dënlime makabre të cilat ngjallën zemërimin e papërbajtshëm si të vetë shkencëtarëve ashtu edhe të simpatizantëve dhe ndjekësve të tyre, që më pas, të verbuar nga inati dhe zemërimi, iu sulën nxjerrjes dhe shpikjes së hipotezave dhe supozimeve të panumërtë kundër predikimeve të kishës dhe besimit në Zot në përgjithësi...

Së dyti: Duhet ditur se, këto teori dhe hipoteza të pathemelita u hodhën dhe predikuani në kohën kur shkenca ishte ende në habat teorikë të saj dhe më vonë - pas progresit shkencor-, vetë shkenca qëna dëshminë e saj për këtësinë dhe paqëndrueshmërinë e shumë e shumë prej këtyre teorive të hedhura dhe predikuara në atë kohë.

Kështu shkenca e aplikuar bashkëkohore, bindjen e ateistëve se materia universale është e përhershme, -e pafillim dhe e pambarim- e ka hedhur poshtë përfundimisht me zbulimin e Ligjit të Termodinamikës.

Në lidhje me këtë çështje një prej shkencëtarëve të famshëm të shkencës bashkëkohore të aplikuar, kanadezi Frank E. Tipler, në librin e tij të titulluar “Shkenca thërret në besim” thotë:

“...Ligjet e Termodinamikës⁶ na bëjnë me dije se trupat qiellorë të këtij universi gradualisht e humbin nxehthinë e tyre dhe po i afrohen finishit që do të datojë me atë kohë kur të gjithë trupat qiellorë të universit do të përfundojnë në temperaturën e 0-zeros- absolute

⁶ Termodinamika është një degë e fizikës që studion ligjet e shndërrimit të energjisë në forma të tjera të energjisë dhe studion gjithashtu edhe efektet e energjisë në vëtitë fizike të trupave. Termodinamika ndër të tjera thotë se: Për shkak të çlirimit miliarda vjeçar të energjisë, shumë trupa qiellorë bartës të energjisë -thënë ndryshe yje- kanë humbur shumë nxehthësi, disa të tjerë kanë arritur në gjysmën e jetës së tyre -prej të cilëve është edhe Dielli ynë - kurse disa të tjerë janë ftohur. Pra termodinamika thotë se mbarë universi me trupat e tij po shkojnë drejt ftohjes absolute...

⁷ Nisur nga kjo nëse universi do të ishte i përhershëm -siç thonë ateistët- duhet që të gjithë trupat e tij prej lashtësisë ta kishin arritur temperaturën e zeros absolute, sepse në bazë të ligjit të Termodinamikës nxehthësia do të ishte shpërndarë nga trupi më i nxehthë tek ai më pak i nxehthë, derisa trupat qiellor të kishin arritur në temperaturën konstante të zeros absolute në të cilën jeta ndalon.

-Unë e njoha Zotin Tim-

(- 375 ° Kelvin) në të cilën merr fund aktiviteti i materies⁷ (pra merr fund jetë)...

Porse Dielli pishtar, yjet e zjarrta dhe Toka e pasur dhe e gjallëruar me format e larinishime të jetës në të, janë argumente të qarta përfaktin se zanafilla e universit përkon me një kohë fillestare.

Pra universi s'është veçse një ndodhi prej ndodhive, një fenomen prej fenomenëve.

Kuptimi i kësaj është se përfundodhinë -ardhjen në ekzistencë- të këtij universi është dashur patjetër një Krijues i Përhereshëm, i Gjithëdijshëm, Posedues i aftësive absolute të pakufi. Ky univers s'është gjë tjetër veçse vepër e duarëve të Tij... ”

Gjithashtu argument i qartë përzanafillën e materies universale dhe përfaktin se ajo nuk i takon përhershëmërissë është edhe hipoteza shkencore e “Big Bang-Shpërthimit të Madh”, përfundë cilën ne bëmë fjalë edhe më parë.⁸

Ky pra është Allahu, i Përherëshmi, Ai që nuk ka nevojë për askënd, ndërkohë që çdo gjë ia ka nevojën Atij.

Ai që e njoihu Allahun dhe e pranoi Atë, s'ka dyshim se i bindet urdhërave dhe dispozitave të Tij të ligjëruara nga librat dhe profetët e Tij, i bindet Kur'anit dhe Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të -me të cilët Allahu vulosi shpalljet dhe profetët e Tij.

Bindet sepse e di se Krijuesi që i ka dhuruar njeriut gjithë këto mirësi, s'ka sesi ta urdhërojë njeriun përfundë keqen e tij, bindet sepse e di se pas kësaj bindje fshihet lumturia e të dy botërave.

Natyra e pastër njerëzore beson çiltërsisht në Allahun, përhershëmërënë dhe mbarë cilësitë e Tij hyjnore.

⁸ Shiko tek shënimini numër 4.

Kjo është natyra e pastër në të cilën e krijoi Allahu i Lartësuar kriesën njerëzore.

Kjo natyrë e pastër mund të ndotet me dyshime të pathemelta dhe të narkotizohet e rreket nga trillet e pavërteta vetëm tek bartësit e mendjeve të cekëta dhe zemrave të dobëta, tek viktimat e opiumit “ateizëm”.

Ateistëtë stolisin dhe veshin “ujkun” trill me lëkurën e qengjët, e zbukurojnë dhe llistrojnë të pavërtetën.

Por e vërteta e pastër është ajo që ka zënë vend në natyrën e pastër njerëzore me të cilën lind njeriu, për sa kohë që kjo natyrë ngelet e papërlyer.

Në lidhje me këtë, i dërguari i Allahut, Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: ”*Cdo foshnje lind në natyrën e pastër njerëzore. Janë prindërit e tij*⁹ *ata që* (ia ndryshojnë natyrën e tij të pastër pasi) *e bëjnë hebre, të krishterë apo adhurues të zjarrit...*¹⁰” -Transmetim nga imam Buhariu-

Ndërsa prindi musliman i mëson fëmijët e tij dhe të gjithë të tjerët me mësimet hyjnore, ku ndër të tjera muslimani me natyrë të pastër i ka marrë edhe njohuritë në lidhje me Cilësitë, Emrat dhe Vetveten hyjnore të Allahut të Lartësuar.

⁹ Pra prindërit me idetë e tyre të gabuara e eirësojnë natyrën e pastër të fëmijëve të tyre. Normalisht krahas prindërvë të prishur tek armiqtë që kanë një rol të drejtëpërdrejtë në prishjen e natyrshmërisë së vërtetë dhe të pastër njerëzore mund të futen edhe shoqëria, media (radio-televizioni), gazetat, revistat dhe interneti që publikojnë gjëra negative, libri shkollor dhe jashtëshkollar negativ, etj.

¹⁰ Imam El-Kurtubij në librin e tij “El-Mufhim-Shpjeguesi” në lidhje me domethënjen e këtij hadithi thotë: “Kuptimi është se Allahu i krijoi zemrat e njerëzve të afta (pra të paisura me një identitet të tillë që) ta pranojnë të vërtetën ashtu siç krijoi sytë dhe veshët e njerëzve në përputhje me pamjet dhe tingujt. Përsa kohë që zemrat ngelen në këtë përputhje dhe identitet -aftësi origjinale- ato arrijnë ta kapin të vërtetën, e bindja Islame është e vërteta...”

Kush më mirë se vetë Allahu dhe vula e profetëve të Tij, Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut goftë mbi të- mund ta mësojnë njerëzimin në mënyrë të saktë për Zotin e tyre?!

Mësimet hyjnore -Kurani dhe Udhëzimi Profetik- na kanë treguar neve për Cilësitë, Emrat dhe Vetveten Hyjnore të Krijuesit tonë dhe gjithë sa ka dashur Ai që neve të dimë në lidhje me Të.

Kurse ato gjëra që Allahu nuk ka dashur t'i dimë nuk na janë treguar, e: “...*mbi çdo të dijshëm ka edhe më të dijshëm.*” Jusuf (76)

Prej Cilësive dhe Emrave Hyjnorë të Allahut, të cilat Ai deshi që ne t'i dimë, janë edhe cilësitë që vetë Allahu i ka përmendur në fjalën e Tij, Kuranin Fisnik, ku në lidhje me këtë çështje thotë:

“*Thuaj: Ai, Allahu, është Një! Allahu është Ai të Cilit çdo kriesë i drejtohet për çdo nevojë. As ka lindur kënd, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Të.*” Suretu El-Ihlas

“*Allahu vërtetoi se, nuk ka zot tjetër përveç Tij, edhe engjëjt, edhe ata që kanë dijeni* (vërtetuan) *se Ai -Allahu- është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot -të adhuruar me të drejtë- përveç Tij, Fuqiplotit, të Urtit.*” Ali Imran (18)

“*Ky është Allahu Zoti juaj. Nuk ka të adhuruar përveç Tij, Krijues i çdo gjëje. Pra, adhurojeni Atë! Ai është Mbikqyrës ndaj çdo gjëje. Vështrimet (e njerëzve) nuk mund ta përfshijnë Atë, ndërsa Ai i përfshin vështrimet. Ai është shumë i kujdesshëm, i Gjithëdijshëm... Zoti yt nuk ka nevojë për asgjë, është Mëshirues. Nëse Ai do, ju zhduk (nga ekzistenca) dhe sjell kë të dojë pas jush, ashtu siç ju solli juve nga pasardhësit e popujve (të tjerë) që ishin para jush*” El-Enam (102-103, ...133)

“Allahun e lartëson me adhurim gjithçka në qiej e në tokë dhe Ai është i Gjithfuqishmi, i Urti. I Tij është pushteti në qiej e në tokë, Ai e jep jetën, Ai e jep vdekjen e Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ai është i Pari (i Përhershmi) dhe i Fundit (në pambarim), i Dukshmi (përmes gjurmëve të urtësisë së Tij në univers) dhe i Padukshmi (për shqisat dhe konceptimin e arsyes njerëzore), dhe Ai është i Dijshmi për çdo gjë.” El-Hadid (1-3)

“Ai është Allahu, nuk ka zot tjetër pos Tij. Ai e ditë fshehtën dhe të dukshmen, Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërsi! Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, Sundesi, Hyjnori, i Pastërti (prej të metave që i mveshin injorantët), Siguruesi, Mbikqyrësi, i Plotëfuqishmi, Mbizotëruesi, i Madhërishmi. I Lartësuar është Allahu nga çfarë i shoqërojnë (në adhurim)! Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të Tij janë emrat më të bukur. Atë e lartëson gjithçka në qiej dhe në tokë. Ai është i Fuqishmi, i Urti!” El-Hashr (22-24)

“O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun, ndërsa Allahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i Falenderuari. Po të dojë Ai ju zhduk dhe sjeil (në ekzistencë) krijesë të re. Për Allahun kjo nuk është e vështirë. Asnjë mëkatar nuk do ta bartë mëkatin e tjetrit, por edhe nëse mëkatari thërret ndonjë për t’ia bartur atë, ajo nuk do t’i bartet atij, edhe nëse (ai që thërret) është një i afërt i tij. Ti mund t’ua tërheqësh vërejtjen vetëm atyre që i `a kanë frikën Zotit të tyre edhe pse nuk e shohin Atë dhe që e falin namazin. Kush pastron veten, ai e ka bërë këtë pastrim për të mirën e vet, se vetëm tek Allahu është e ardhmja. Nuk janë të barabartë i verbëri dhe ai që sheh. As errësirat e drita. As hija me vapën. Nuk janë të njëjtë as të

-Unë e njohat Zotin Tim-

gjallët e të vdekurit. Allahu bën të dëgjojë atë që do, ndërsa ti nuk mund ta bësh të dëgjojë atë që është në varr. Ti nuk je tjetër vetëm se një i dërguar që tërheq vërejtjen. Ne të dërguam ty me të vërtetën, përgëzues dhe qortues, e nuk pati asnijë nga popujt që nuk kishte të dërguar. E nëse të përgënjeshtrojnë ty, përgënjeshtruan edhe ata që ishin para tyre, të cilëve u kishin ardhur të dërguar me argumente të qarta, me broshura dhe me libër të ndritshëm. Pastaj (pasi refuzuan) i shkatërrova ata që nuk besuan, sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im?! A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, me të nxjerrim fruta ngjyra e të cilave është e ndryshme, edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Në realitet Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, dijetarët. Allahu është mbi gjithçka, është Mëkatfalës". El-Fatir (15-28)

2) Njohja e emrave dhe cilësive të Allahut.

Njohja e cilësive të Allahut na mundëson të marrim një njohuri të plotë për Të.

Është fakt se sa më shumë të shtohet njohuria e njeriut në lidhje me cilësitë e një diçkaje aq më tepër shtohet njohuria e tij për të.

Kështu, që ne ta njohim sa më mirë Allahun, duhet që t'i njohim dhe mësojmë cilësitë e Tij të përsosura dhe të plota, sepse kjo gjë na bën që t'i drejtohem i Allahut duke e ndier madhështinë e Tij, duke u udhëhequr nga udhëzimi i Tij, duke e dashur Allahun e Lartësuar që posedon përsosmërinë e plotë. Duke u mbështetur për të gjitha çështjet tona vetëm tek aftësia dhe plotfuqishmëria e Tij, duke shpresuar faljen, nderimin dhe shpërblimin e Tij, duke patur frikë ndëshkimin e Tij, duke e përmendur dhe përkujtuar Allahun me cilësitë e përsosura që i takojnë. Duke qenë të bindur se Allahu i Lartësuar është i Pastër dhe larg çdo mangësie dhe të mete që ia kanë përshkruar padrejtësisht njerëzit injorantë.

Pra sa më tepër të zgjerohen njohuritë tona në lidhje me cilësitë e Zotit tonë, aq më tepër zgjerohet njohuria dhe dituria jonë për Zotin e Lartësuar dhe vetëm duke mësuar rrëth cilësive të Krijuesit tonë ne arrijmë ta konkretizojmë urdhërin e Allahut të Lartësuar që thotë në Kuranin fisnik: “*Atëherë mësoje se nuk ka Zot tjetër përvëç Allahut dhe kërko falje për mëkatin tënd.*” Muhammed (219)

Dhe në këtë mënyrë arrijmë t'i mbrojmë dhe pastrojmë zemrat dhe mendjet tona nga çdo mangësi që nuk duhet t'i adresohet dhe mvishet për cilësi Krijuesit të Lartësuar.

Rëndësia e njohjes dhe mësimit të cilësive të Allahut të Lartësuar.

Shtetasit apo banorët e një vendi, nëse arrijnë të njohin cilësitë e udhëheqjes dhe pushtetit që kanë mbi krye, kanë mundësi t'i sistemojnë dhe formojnë sjelljet, punët, fjalët dhe qëndrimin e tyre, në varësi të këtyre cilësive.

Nëse mësojnë se udhëheqja e tyre dhe pushteti që kanë mbi krye karakterizohen nga drejtësia dhe korrekëtësia, atëherë zgjedhin rrugët që nuk bien ndesh me drejtësinë e shtetit, por nëse mësojnë se udhëheqësia e tyre dhe pushteti që kanë mbi krye karakterizohen nga padrejtësia dhe diktatura, atëherë zgjedhin rrugët e mundëshme që mund t'i shpëtojnë ata nga diktatura dhe e keqja që mund t'u vijë nga kjo udhëheqje apo ky pushtet.

Kështu pra, sa më tepër që të shtohet dituria e tyre në lidhje me cilësitë e udhëheqjes dhe pushtetit që kanë mbi krye, aq më tepër kanë aftësi të përcaktojnë qëndrimin e duhur që u sjell atyre dobi dhe i mbron nga dëmet dhe gjërat e padëshiruara -Shembulli më i lartë i takon Allahut-.

Allahu është Poseduesi i cilësive të larta dhe të përsosura, është i Pastër dhe larg çdo të mete dhe mangësie. Ai është Poseduesi i urdhërit dhe vendimit të prerë që gjen zbatim të patjetërsueshëm.

Njohja e Allahut dhe cilësive të Tij hyjnore është dituria dhe njohuria më e parë dhe më e rëndësishme që duhet të dijë çdo njeri i arsyeshëm.

• Njohja e Allahut ashtu siç duhet na bëni neve që ta madhërojmë Atë siç i takon dhe t'i japim Atij

meritat që i meriton. Allahu i Lartësuar e dënon në Kur'anin Fisnik injorancën në të cilën jetonin arabët idhujtarë pasi: “*Ata* (idhujtarët injorantë) *nuk e çmuan Allahun me atë madhështi që i takon...*”

Ez-Zumer (67)

• Njohja dhe mësimi i cilësive që nuk duhet t'i adresohen Allahut të Lartësuar na shpëton dhe mbron që të mos biem në injorancën që mund të na bëjë t'i shoqërojmë Zotit cilësi dhe gjëra që Ai nuk i pëlqen.

Pikërisht kjo njohje na ruan të mos humbasim dhe të mos largohemi nga udhëzimi i drejtë dhe i vërtetë.

Kurse në të kundërt do të biem viktima të shpifjes dhe trillit më të rëndë, shpifjes dhe trillit në adresë të Allahut, dhe të meritojmë ndëshkimin e Allahut të Lartësuar.

Thënia e mëposhtme Kur'anore flet qartë në lidhje me sa thamë më lart: “(Edhe pasi u erdhi atyre udhëzimi i argumentuar qartë) *Ata* (injorantët në njëshmërinë e Allahut) *thanë: “Allahu ka fëmijë”. Larg kësaj është Allahu, Ai s'ka nevojë*¹¹. *E Tij është çka në qiej dhe në tokë. Ju nuk keni argumente për këtë. A thoni për Allahun çfarë nuk dini?! Thuaj: “Ata që trillojnë gënjeshtër për Allahun nuk kanë për të shpëtuar.”*

Junus (68-69)

Gjithashtu njohja e cilësive të padenja për t'iu adresuar Allahut na mundëson dhe udhëzon që të mos e përshkruajmë dhe cilësojmë Allahun me asnje mangësi ose të metë të tillë.

¹¹ Njeriu ka nevojë të ketë fëmijë sepse: Së pari shfryn epshin e tij, pastaj kënaqet dhe krenohet me fëmijën përfiton prej tij dhe gjenë përkrahje tek ai... Gjithashtu fëmija është trashëgues dhe përhapës i emrit dhe famës së prindit. Pra shkurt fëmija plotëson shumë mangësira të njeriut, kurse Allahu i Lartësuar nuk ka nevojë për asnjë nga çfarë parathamë sepse Ai posedon cilësitë e përsosura e të plota.

-Unë e njoha Zotin Tim-

- Njohja e cilësive të Allahut të Lartësuar na ndihmon që ta adhurojmë Allahun ashtu siç i takon dhe ashtu siç Ai na urdhëron në Kuranin Fisnik ku thotë:

“ Prandaj vetëm Allahun adhuroje dhe bëhu mirën johës .” Ez-Zumer (66)

Cilësitë e larta, të plota dhe të përsosura i takojnë vetëm Allahut.

Duke qenë se cilësitë e ndjekin poseduesin e tyre -e ngrejnë ose ulin atë- atëherë Allahu i Lartësuar që posedon cilësitë më të larta, më të plota dhe më të përsosura është Poseduesi i vetëm i përsosmërisë dhe artributeve të plota, prandaj Allahu thotë për veten e Tij në Kuranin Fisnik:

“...Shembëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e në tokë dhe Ai -Allahu- është Mbizotëruesi, i Urti.” Er-Rum (27)

Në fakt çdo cilësi e përsosur që vërehet tek krijesat¹² e këtij universi nuk është tjetër veçse argument i qartë që dëshmon madhështinë dhe përsosmërinë hyjnore të Krijuesit të Lartësuar që i solli në këtë ekzistencë mbarë krijesat dhe i pajisi ato me cilësitë e tyre të mahnitëshme.

Arsyeja e shëndoshë e din mirë se Krijuesi ndryshon nga krijesat e Tij, nisur nga këtu kuptohet qartë fakti se edhe cilësitë e Krijuesit nuk janë si cilësitë e krijesave të Tij.

Cilësitë e Allahut janë aq madhështore saqë mendja dhe imagjinata jonë e ngushtë nuk mund ta konceptojnë realitetin dhe natyrën e tyre, prandaj rruga e vetme për t'i njojur ashtu siç duhet cilësitë hyjnore është mesazhi hyjnor.

¹² Në realitet ne nuk shikojmë veçse një pjesë tepër të vogël të krijesave të Allahut.

Cilësitë e Allahut të Lartësuar janë të përsosura dhe të shumta në numër.

Dihet mirë fakti se madhështia dhe përsosmëria e diçkaje ka të bëjë me numrin e cilësive madhështore dhe të përsosura që ajo posedon.

Nëse të thuhet për shembull për një makinë se ajo është një makinë e shpejtë, pastaj të thuhet është e sigurtë, pastaj se është e rehatshme, pastaj se mund të fluturojë, se mund të vozisë mbi ujë etj; do të gjesh se vlera e kësaj makine shtohet në mendjen dhe imagjinatën tënde në varësi të numrit të cilësive të vyera që ka kjo makinë, -e për Allahun është shembulli më i lartë-.

Kështu, njeriu:

- Kur shikon dimensionet gjigande të këtij universi rrënqethet, drithërohet dhe ndjen një si ndjesi frike marramendëse... dhe sakaq kupton dhe njeh madhështinë e Krijuesit të këtij universi, prandaj e çmon Krijuesin ashtu siç Ai e meriton.

- Kur mendon për lartësinë e qiellit dhe hapësirën qjellore, që për sytë e tij është e pasund, mahnitet dhe sakaq kujtohet se Krijuci është edhe më i Lartë, prandaj e madhëron dhe adhuron edhe më me devotshmëri dhe largpamësi Krijuesin e tij të Lartësuar.

- Kur mediton në lidhje me forcën gjigande që me një preçizion dhe ekuilibër të mahnitshëm vë në lëvizje mbarë përbërësit e universit -që nga galaktikat dhe yjet gjigandë e deri tek atomet dhe elektronet mikroskopikë-,

kujtohet se Krijuesi posedon forcën supreme, prandaj çdo forcë tjetër pëpara forcës së Allahut te Plotëfuqishëm tkurret dhe bëhet e papërfillshme në mendjen dhe imagjinatën e tij.

• Kur shikon bukurinë dhe hijeshinë tërheqëse të krijesave që ia pushtojnë tërësisht shqisat dhe ndjenjat, bindet se bukuria e Allahut qëndron sipër çdo cilësie sado të bukur të krijesave.

• Kur shikon cilësitë e spikatura të krijesave arrin të kuptojë se këto krijesa me cilësitë e përsosura që posedojnë nuk janë veçse gjurmë që tregojnë për Krijuesin e tyre, nuk janë veçse vepra që dëshmojnë për Bërësin e tyre, nuk janë veçse krijesa që reflektojnë disa nga cilësitë e Krijuesit të tyre.

Dihet mirë se cilësitë e Krijuesit janë më të përsosura se cilësitë e krijesës së Tij.

Nuk mund të imagjinohet që Krijuesi të jetë si krijesa e Tij dhe që cilësitë e Tij të jenë si cilësitë e tyre, porse logjika e shëndoshë fton në bindjen e paluhatshme se cilësitë e Zotit të mbarë krijesave qëndrojnë më lartë se çdo cilësi e krijesave dhe sfidojnë fantazinë dhe imagjinatën e çdo personi.

Kjo është bindja e njeriut të arsyeshëm, nëpërmjet së cilës ai kupton se rruga e vetme që mund ta shpjerë njeriun tek mësimi dhe njohja e saktë e cilësive të përsosura dhe të pakrahasueshme të Krijuesit të tij është mesazhi hyjnor.

Cilësitë e mahnitshme tek krijesat janë një shembull i gjallë për mënyrën se si duhet t'i kuptojmë cilësitë e përsosura të Allahut.

Nëse do t'i flisje një personi që ka jetuar para qindra vitesh për televizorin dhe do t'i tregoje se në ekranin e tij njeriu shikon dhe dëgjon drejtpërsëdrejti dikë që gjendet mijëra kilometra larg tij, në një vend që mund t'i përkasë edhe skajeve më të largëta të botës, sigurisht që ky person do të çuditej shumë dhe nuk do mund të imaginonte se si realizohet dhe bëhet e mundur një gjë e tillë.

Nëse ti do të vazhdoje t'i tregoje atij se: Gjithkush që gjendet në tokë -në ajrin, dheun apo ujin e saj, nëpërmjet ekranit të internetit apo celularit mund të dëgjojë dhe shikojë çdo person kudo qoftë ai dhe pa patur nevojë të lëvizë nga vendi i tij, atëherë personi në fjalë do të çuditej dhe habitej edhe më shumë.

Pastaj po qe se do t'i flisje atij edhe për energjinë elektrike, sesi ajo nga vendi i prodhimit të saj, nëpërmjet telave të varura në shtyllat e tensionit, përçohet në të gjithë skajet e vendit dhe vë në punë fabrikat, makineritë elektroshtëpiake, ndriçon sheshet dhe rrugët e fshatrave e qyteteve, dhe me gjithë këtë askush nuk mund ta shikojë atë, atëherë si mendon se do të reagonte ky person?!

A do kishte ai mundësi t'i imaginonte gjithë këto gjëra? Pastaj po qe se do të vazhdoje t'i tregoje për çuditë e kompjuterit, që s'është veçse një send, se sa shpejtë dhe saktë i zbaton urdhërat që i jep njeriu, atëherë dëgjesi yt-i cili e gjykon botën me mentalitetin njerëzor të para qindra viteve- do të zhytej edhe më thellë në çudinë

dhe habinë e tij për sa i thua. Madje sa parathamë do ta habisnin edhe një bashkohësin tonë që jeton në malësitë e thella, larg qytetërimeve. Lind pyetja: E përse kjo habi, përse kjo çudi?

Përgjigjja është: Sepse ky person në kohën apo mjeshterin ku ka jetuar nuk ka dëshmuar gjëra me cilësi të tillë si këto që i tregohen. Por sidoqoftë, do besojë apo jo ky person në këto të vërteta që i thuhen, përsëri e vërteta ngelet e vërtetë.

Atëherë ç'mund të thuhet dhe mendohet prej nesh-krijesave njerëzore- në lidhje me cilësitë madhështore, të përsosura dhe të pakrahasueshme të Allahut të Lartësuar, ndërkohë që ne njerëzit jetojmë në një botë ku nuk shohim veçse krijesa të Allahut, cilësitë e të cilave nuk i pëngajnjë kurrsesi asnjë prej cilësive të Allahut?!

Por sado që ndonjë mohues t'i mohojë cilësitë e mahnitshme, të pakrahasueshme dhe të përsosura të Allahut, realiteti ngelet që këto cilësi të mahnitshme e të paimagjinueshme për neve, janë një e vërtetë e pamohueshme e Krijuesit të Lartësuar, poseduesit të përsosmërisë së plotë.

Kështu pra, njeriut të arsyeshëm s'i ngelet veçse t'i besojë atributet e përsosura dhe të paimagjinueshme të Allahut, ashtu siç i vijnë nga burimi më i saktë informativ që ekziston, mesazhi hyjnor, duke mos i komentuar dhe duke mos tentuar të kuptojë realitetin dhe si-në e tyre.

Gjithashtu madhështia dhe përsosmëria e cilësive të mahnitshme, të paimagjinueshme dhe të pakrahasueshme të Krijuesit të Lartësuar që pëmenden në mesazhin hyjnor nuk duhet kurrsesi tëjenë shkak për të hezituar, dyshuar apo kundërshtuar në lidhje me atë që thotë mesazhi hyjnor, por përkundrazi ato duhet të ngjallin tek njeriu i arsyeshëm madhërimin, bindjen, nënshtrimin dhe udhëzimin e vullnetshëm në atë që thotë mesazhi hyjnor.

Si mund t'i mësojmë cilësitë e Allahut të Lartësuar.

Duhet ditur se cilësitë e Allahut janë të tre natyrave kryesore:

Së pari: Cilësitë e Allahut të Lartësuar të skalitura tek veprat e Tij.

Nga këto cilësi përmendim krijimin, furnizimin, mbrojtjen, përkujdesjen, përsosjen, formësimin... e të tjera cilësi, gjurmët e të cilave duken qartazi në materien dhe ligjet e këtij universi.

Njeriu duke parë dhe studiuar materien dhe ligjet e këtij universi, mund të grumbullojë në mendjen e tij sasi të pashtershme argumentesh dhe gjurmësh që pasqyrojnë qartë cilësitë me të cilat Krijuesi i Lartësuar krioi dhc solli në ekzistencë mbarë kriesat e universit.

Këto argumente dhe gjurmë janë dëshimi e gjallë që dëshmojnë për këtë natyrë të cilësive të Allahut, Krijuesit të këtij universi gjigand.

Porse realiteti, si-ja, sfera dhe dimensionet e këtyre cilësive të Krijuesit Sovran, ngelen përtej çdo imagjinate dhe nuk mund të konceptohen nga mendja e ngushtë e njeriut, dritat e së cilës -pesë shqisat- janë të kushtëzuara dhe kufizuara për të depërtuar tek realiteti, natyra dhe si-ja e cilësive të pakrahasueshme, të pakushtëzuara dhe të pakufizuara të Allahut të Lartësuar.

E si mundet i varféri njeri, që ka një kapacitet mendimi dhe imagjinate të kufizuar, që jeton në një tokë të kufizuar dhe për një kohë të kufizuar, të kuqtojë realitetet dhe të vërteta që nuk karakterizohen me asnjë nga këto

karakteristika tē mangëta tē njeriut dhe qëndrojnë më larg sesa mund tē arrijë konceptimi dhe imagjinata e ngushtë e tij.

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar në një sërë vendesh në librin e Tij -Kuranin Fisnik- që tē vështrojmë dhe meditojmë në lidhje me gjurmët që kanë lënë cilësitë vepruese tē Allahut në qiell dhe në tokë.

Në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë: “*Shiko pra gjurmët e mëshirës së Allahut, sesi e njall tokën* (bën tē çelin në tē bimët) *pas vdekjes së saj* (pasi ishte e shkretë, pa asnjë bimë në tē) *dhe s'ka dyshim se Ky është Ai që do t'i ngjallë tē vdekurit sepse Ai është i Plotfuqishëm tē bëjë çdo gjë.*” Er-Rum (50)

“*A nuk i shikojnë* (mosbesimtarët dhe meditojnë për) *devetë se si* (sa përsosmërisht dhe sa mrekullueshëm) *janë krijuar?! Edhe qielin se si është ngritur?! Edhe kodrat* (dhe malet) *si janë vendosur?! Edhe tokën se si është shtruar* (sheshuar)?!” El-Gashije (17-20)

E thënie tē tilla si këto thënie që i ftojnë njerëzit e arsyeshëm në meditim ka plot në Kuranin Fisnik.

Së dyti: Cilësitë që kanë tē bëjnë me Vetveten e Allahut.

Pra askush nuk mund ta përfshijë në dijen e tij dhe ta konceptojë me shqisat e tij Vetveten Hyjnore tē Allahut dhe si-në e Saj?!

Vetë Allahu i Lartësuar tregon në Kuranin Fisnik për tē gjitha krijesat e arsyeshme se: “...Dija e tyre nuk mund ta përfshijë Atë -Allahun-...” Taha (110)

Askush nuk mund ta imagjinojë në imagjinatën e tij pamjen e Allahut?!

Dihet mirë se njeriu kur imagjinon diçka, referohet tek gjërat që ngjajnë ose janë tē ndryshme me këtë diçka, por ku mund tē referohet imagjinata e njeriut për tē

imagjinuar Allahun kur dihet se prej cilësive të Tij -siç përmendet në Kuranin Fisnik- është se: “...*Asgjë nuk i përngjan Atij* -Allahut- (asgjë nuk është si Ai)...”

Esh-Shura-Konsulta (11)

Nuk ka asnjë rrugë për t'i njohur cilësitë që kanë të bëjnë me Vetveten Hyjnore të Allahut përveçse duke na treguar neve për këtë gjë vetë Krijuesi që i posedon këto cilësi dhe e njeh më mirë se çdokush Vetveten e Tij.

Kurse i dyti dhe i fundit që mund të na tregojë neve për cilësitë e Vetvetes Hyjnore të Allahut është i dërguari i Tij që në realitet është përcuesi që përçon dhe transmeton tek neve mesazhin hyjnor të Vetë Allahut.

Kështu pra, rruga e vetme që mund të na njohë me cilësitë hyjnore është libri i Allahut dhe thëniet e profetit të Tij, pra thënë ndryshe mesazhi -shpallja- hyjnore.

Kur të arrijë te ne mesazhi hyjnor nëpërmjet të cilit Zoti ynë na tregon rrreth Vetvetes së Tij dhe na njeh me cilësitë e Tij.

Atëherë s'na ngelet përveçse të besojmë dhe të dorëzohemi përpara mesazhit hyjnor edhe pse mendjet tonë mund të mos i konceptojnë dhe kuptojnë këto cilësi të mahnitshme dhe të përsosura, e edhe pse imagjinata jonë nuk mund të gjejë ndonjë shembull të përngjashëm me to.

Kështu, mesazhi hyjnor na tregon se dëgjimi i Allahut të Plotfuqishëm i kap dhe përfshin gjithçka do Ai; se vështrimi i Tij depërton kudo që Allahu do... e kështu me rradhë të gjitha cilësitë e Tij janë të përsosura, të pakushtëzuara dhe të pakufizuara.

Së treti: Cilësitë që kanë të bëjnë me sovranitetin e Allahut.

Si për shembull të folurit e Tij, zemërimi i Tij nga veprimi i gjërave që Ai i ka ndaluar, kënaqësia e Tij kur kryhen vepra që e kënaqin Atë, ndihmesa e Tij për besimtarët, qëllimi për të cilin Ai e krijoi njeriun etj.

Sigurisht edhe këto cilësi që i takojnë Vetvetes Hyjnore të Allahut, ashtu si pararendëset e tyre, nuk mund të mësohen dhe njihen përveçse nëpërmjet mesazhit hyjnor.

Injorancë që shpie në humbje.

Disa prej njerëzve ndoqën një rrugë të pasaktë për të njohur dhe mësuar cilësitë e Allahut dhe ishte pikërisht kjo rrugë e gabuar ajo që i shpuri ndjekësit e saj në shtrembërimin e së vërtetës, në një gabim të pajustifikueshëm dhe në një humbje të errët.

Prej këtyre rrugëve të gabuara mund të përmendim:

A- Përngjasimin dhe shëmbëllimin e Allahut, Krijuesit, me krijesat.

Gabimi më i madh dhe më i pafalshëm në të cilin ranë disa njerëz është se ata krahasuan në mes Krijuesit dhe krijesave dhe i menduan cilësitë e Krijuesit të njëjtë ose të ngjashme me ato të krijesave.

Të tillë njerëz, cilësitë që Allahu i përmend në mesazhin hyjnor, i imagjinuan duke i krahasuar me cilësitë e njeriut dhe -Zoti na faltë- e imagjinuan Zotin një njeri gjigand...

Pikërisht përngjasimi dhe shëmbëlli i që ata i bënë Krijuesit me krijesat i bëri këta fantazues pafre dhe ndjekësit e tyre të bien në një humbje dhe injorancë të madhe.

E gjitha kjo sepse ata nuk e frenuan fantazinë dhe imagjinatën e tyre të gabuar përpëra parimit atribual me të cilin Allahu i Lartësuar e përshkruan Vetveten e Tij në Kur'anin Fisnik -mesazhin hyjnor- kur thotë se: "...*Asgjë nuk i ngjan Atij -Allahut-...*" Esh-Shura-Konsulta (11)

B- Komentimi i cilësive të Allahut se ato janë cilësi jokonkrete dhe figurative, pra, me fjalë të tjera, mohimi i realitetit dhe vërtetësisë së cilësive të Allahut.

Kjo gjë erdhi si rezultat i të njëjtit gabim që përmendëm më lart. Cilësitë që Allahu i Lartësuar ia atribuoi Vetvetes së Tij Hyjnore në mesazhin hyjnor, Kuranin Fisnik, i konsideruan dhe menduan të ngjashme -madje pati prej tyre edhe kush i konsideroi dhe mendoi ato të njëta- me cilësitë e krijesave.

Por -pas këtij imagjinimi krejtësisht të gabuar dhe të pavend- gjetën se cilësi të tilla ishin të padenja t'i adresoheshin Krijuesit.

Pati prej tyre që i komentoj këto cilësi si cilësi jokonkrete -figurative dhe të pavërteta-, duke mohuar në këtë mënyrë vlerat reale dhe të vërteta që ato përbajnë në vetvete.

Disa mohuan realitetin e çdo cilësie kurse disa të tjérë mohuan realitetin e një pjese të cilësive të Allahut që përmendi mesazhi hyjnor.

- Mund të themi se gabimi i të dy këtyre grupeve ishte i njëjtë:

“Gabimi i tyre ishte përpjekja dhe mundimi i tyre për t'i konceptuar dhe kuptuar me mendjen dhe imagjinatën e tyre cilësitë e përsosura të Allahut.”

Për të arritur në dhënen e idesë së tyre në lidhje me cilësitë e Allahut ata s'kishin ku të referoheshin përvëçse tek kjo ekzistencë, dhe në këtë mënyrë *ranë në këtë gabim trashanik atëherë kur krahasuan në mes cilësive të Krijuesit dhe cilësive të krijesave, kur krahasuan të padukshmen dhe të pakonceptueshmen -cilësitë e Krijuesit- me të dukshmen dhe të konceptueshmen - cilësitë e krijesave-.*

U zhytën në një filozofi të paekuilibruar që i largoi shumë larg udhëzimit hyjnor.

Sepse që të kesh leje dhe mundësi të krahasosh në mes dy gjërave duhet që këto dy gjëra të janë të

ngjashme, kurse Krijuesi mund të shëmbëllehet dhe të krahasohet me krijesat e Tij, -e Allahut i takon shembulli më i lartë- aq sa mund të shëmbëllehet dhe krahasohet njeriu me gjërat që ka bërë mendja dhe dora e tij.

Gabimi i tyre ishte se ata e zhytën mendjen në një çështje që s'i takonte, në një çështje ku ajo nuk mund të konceptojë dhe bëjë asgjë, në një çështje që qëndron përtej astësisë konceptuese dhe kuptuese të saj, prandaj ajo u çorientua dhe gaboi.

Ata e ngarkuan mendjen me një barrë më të rëndë se sa mund të mbante, prandaj ajo dha një përgjigje të pasaktë dhe të paekuilibruar...

Shembulli i mendjes në këtë rast i ngjan shembullit të një personi të cilit i kërkohet të përshkruaj se çfarë gjendet brenda një sunduku të mbyllur si dhe çfarë cilësish kanë gjërat që gjenden në të, ose njëloj sikur t'ia mbyllësh sytë një personi dhe ta fusësh në një dhomë ku s'ka qenë kurrë më parë dhe t'i kërkosh që me sy mbyllur t'i përshkruaj orenditë e kësaj dhome dhe cilësitë e tyre.

Si mundet një person i tillë të flasë diçka, pa patur mundësi të shikojë tek këto gjëra, ose pa i treguar atij dikush tjetër që i ka parë ato.

Ky person nuk ka sesi ta dijë me siguri se cilat janë cilësitë e këtyre gjérave. Edhe po foli do flasë me hamendje dhe kush flet me hamendje patjetër që do gabojë.

Kështu është shembulli i mendjes dhe imagjinatës sonë të kufizuar dhe pesë shqisave të njeriut. Ajo nuk mund të dijë asgjë në lidhje me cilësitë e Allahut, natyrën dhe sinen e këtyre cilësive.

Asaj s'i ngelet përveçse të kufizohet në atë që i ka ardhur nëpërmjet mesazhit hyjnor, të kufizohet në atë çfarë ky mesazh përmend në lidhje me cilësitë e përsosura të Allahut.

Mendja dhe mesazhi hyjnor.

Në fakt mendja nuk ka mundësi të verifikojë dhe hetojë thëniet e mesazhit hyjnor në lidhje me atributet e Allahut për vetë faktin e thjeshtë se mesazhi hyjnor bart në vetvete diturinë e Allahut që është e plotë dhe qëndron superiore mbi diturinë e kufizuar të njeriut e cila përcillet tek ai nëpërmjet pesë shqisave të tij, që dihet mirë se kanë një sferë tepër të kushtëzuar dhe kufizuar.

Le të përmendim një shembull të thjeshtë që shpjegon sa thamë më sipër:

Dituria e mjekut specialist -në fushën e mjeksisë- është më e plotë dhe më e gjerë se dituria e pacientit të zakonshëm që vizitohet dhe kurohet tek ai, prandaj nuk mund të imagjinohet dhe mendohet që një patient i arsyeshëm ta provojë me mendjen e tij saktësinë apo vërtetësinë e diagnozës së sëmundjes dhe kurimit -trajtimit mjeksor- që i ka vënë atij mjeku specialist.

Porse e vërteta është se pacienti dorëzohet përpara diturisë dhe aftësisë së mjekut specialist, pasi është bindur më parë për aftësinë profesionale të tij.

Kështu edhe mendjes nuk i ngelet veçse të jetë një mjet që e mundëson poseduesin e saj të kuptojë, studjojë dhe bindet në faktin se: A është ajo çfarë i ka arritur atij - çfarë lexon apo dëgjon- vërtet e ardhur nga mesazhi hyjnor?

Kjo gjë bëhet vetëm duke vërtetuar se: A është apo jo ai që e ka përcjellë dhe përçuar këtë thënie tek neve profet i dërguar nga Allahu?

Pikërisht për këtë gjë duhet të grumbullojë fakte dhe argumente mendja, pra se a është apo jo prej mesazhit hyjnor ajo ç'ka i ka arritur mendjes.

Kurse pasi mendja dhe arsyaja të bindet se ajo që i ka arritur asaj është prej mesazhit hyjnor, si ngelet veçse të dorëzohet përpara saj edhe nëse nuk arrin ta konceptojë, kuptojë dhe hetojë nëpërmjet diturisë së saj të pakët atë që thotë mesazhi hyjnor.

Sepse dija e Allahut është një dije e plotë që qëndron shumë më lart se dija dhe aftësia kuptuese e njeriut.

Prandaj mendja duhet që të bindet në lidhje me transmetimin¹³ që i arrin asaj nëse ai më të vërtetë e ka origjinën tek mesazhi hyjnor, e pas kësaj mendja në lidhje me njoburitë ku nuk depërton dot duhet të përfitojë nga njoburitë që i sjell asaj mesazhi hyjnor prej çështjeve dhe njoburive që ndodhin jashtë sferës së shqisave të kufizuara -dritareve nga ku e sheh botën mendja njerëzore-.

Tek njoburitë e këtij lloji hyjnë për shembull:

Njohja e Allahut dhe e cilësive të Tij, mësimi i ekzistencës së Xhenetit dhe Xhehenemit dhe njohja e karakteristikave të tyre, qëllimi për të cilin Allahu e krijoj njeriun dhe këtë univers, si dhe çështje të tjera ku nuk mund të depërtojë mendja dhe dituria e njeriu

¹³ Karakteristikë e veçantë e mesazhit hyjnor islam është mbrojtja e tij nëpërmjet zinxhirit të pakëputur të trasmetuesëve të besueshëm qysh nga koha e fillimit të shpalljes së mesazhit hyjnor islam dhe deri në ditët tona. Kurse thëniet që thuhen në adresë të mesazhit hyjnor dhe që kanë zinxhir transmetimi të këputur dhe trasmetues të dyshimtë që s'i plotësojnë kushtet që duhet të ketë trasmetuesi për t'iu pranuar atij transmetimi, konsiderohen thënie të pasakta dhe të pabaza dhe nuk lejohet t'i adresohen mesazhit hyjnor.

Mendja dhe imagjinata.

Përmgjasimi dhe krahasimi i cilësive të Krijuesit me ato të krijesave është një injorancë pas së cilës nuk ka injorancë.

Gabimi më i madh në të cilin ra njeriu është se ai u mundua të kuptojë dhe konceptojë me mendjen e tij të kufizuar çështjen e Krijuesit, natyrën dhe si-në e Cilësive dhe Vetvetes së Tij Hyjnore, duke i krahasuar Cilësitë e Krijuesit me cilësitë e krijesave.

Kjo gjë që bënë disa prej njerëzve në fakt hyn në kapitullin dhe rangun e papranueshëm të arsyetimeve, sepse këta njerëz u munduan ta kuptojnë të fshichtën, të padukshmen dhe të pakonceptueshmen duke e krahasuar atë me të dukshmen dhe të konceptueshmen.

Pra përmgjasuan të dukshmen me të padukshmen dhe të njohurën me të panjohurën¹⁴.

A ka injorancë përtej kësaj injorance?!

Për ta shpjeguar më qartë këtë injorancë të madhe po japim shembullin në vijim:

Le ta dëgjojmë së bashku me vëmendje shembullin e titulluar “Hekuri që flet”:

“Në kohët e herëshme, një malësor që jetonte në një malësi të thellë ndodhi të zbriste dhe shkonte në një

¹⁴ A e pranon logjika e shëndoshë faktin që njeriu për ta imagjinuar një qytet që nuk e ka parë kurrë dhe as mund ta shikojë, ta krahasojë dhe përmgjasojë atë me qytete që ka parë ose dëgjuar për to?!

qytet tē zhvilluar dhe aty pa një radio. Kur u kthyte tek banorët e fshatit tē tij tē thellë malor u tregoi atyre për gjërat e habitshme dhe tē çuditshme që kishte parë në qytet. Ndër tē tjera u tha atyre: Pashë një gjë prej hekuri që fliste (kishte për qëllim radion)... Ky person njihej në mesin e popullit tē vet si njeri i singertë sepse ai nuk i kishte gënjeri ata kurrë më parë. Ndodhi që ky person shumë shpejt vdiq dhe pas vdekjes populli i tij filluan tē diskutonin dhe pyesnin njëri-tjetrin në lidhje me ç'ka u kishte thënë bashkëfshatari i tyre i singertë. Filluan ta vrisnin mendjen se si fliste ky hekur. Thanë: Asgjë nuk mund tē flasë nëse nuk ka gjuhë prandaj ky hekur duhet tē ketë gjuhë se s'bën... Pastaj vazhduan: Por që ai tē ketë gjuhë duhet që tē ketë edhe gojë. Dhe përderisa ka gojë dhe gjuhë atëherë ky hekur edhe han edhe pin..."

E kështu, ata e përshkruan hekurin që fliste se ai kishte gjuhë, gojë, hante, pinte... derisa në fund e imagjinuan atë një njeri, por, prej hekuri.

Në qoftë se do tē mendosh mirë në lidhje me këtë shembull do arrish tē kuptosh se imagjinimi i tyre i gabuar në lidhje me realitetin e radios erdhi si pasojë se ata u munduan ta kuptojnë çështjen e fshehtë tē "hekurit që fliste" duke u referuar tek bota e dukshme ku ata jetonin dhe ku i vetmi që fliste ishte njeriu.

Pra gabimi i tyre ishte se ata e krahasuan tē padukshmen me tē dukshmen, dhe tē panjohurën me atë që njihnin. Menduan se përderisa cilësia e tē folurit ishte e përbashkët tek tē dy -tek ky hekur që fliste dhe njeriu- atëherë edhe mënyra e tē folurit duhet tē ishte e njëjtë dhe e përbashkët, porse e vërteta qëndron se me gjithëse edhe njeriu flet e edhe ky hekur fliste, mënyrat e tē folurit tē tyre ndryshojnë dhe i përshtaten natyrës tē çdonjërit prej tyre.

Kështu, njeriu flet në një mënyrë që i përshtatet natyrës së tij kurse "hekuri", radioja, flet në një mënyrë tjetër që i përshtatet natyrës së saj.

Le të supozojmë se malësori që vizitoi qytetin dhe pa ndër gjërat e çuditëshme edhe “hekurin që fliste” -radion- mësoi në qytet mënyrën se si arrinte të fliste ky hekur.

Nisur nga ky fakt neve mund të na lind pyetja se përse ky person nuk i tregoi popullit të vet përmënyrën se si fliste ky hekur dhe se kujt i përngjante ky hekur që fliste?

Le ta japim neve pëgjigjen që mund ta kishte dhënë ky malësor:

Së pari: S’do kishte me kë ta përngjasonte këtë hekur që fliste sepse as ai dhe as populli i tij, të cilit do t’ia përngjasonte atë, nuk njihnin ndonjë gjë të ngjashme, prandaj ai nuk u tha atyre pashë një hekur që fliste dhe që i përngjante njeriut. Nëse kjo gjë do të ishte e vërtetë, do ta kishte thënë pa hezitim, por ai u tha vetëm që pashë një hekur që fliste dhe përderisa nuk e përngjasoi “hekurin që fliste” ai që e kishte parë atë, atëherë me ç’të drejtë mund ta përngjasojë atë dëgjesi që nuk ka parë dhe nuk di asgjë në lidhje me të?!

Së dyti: E zëmë se ky person e mësoi mënyrën se si arrinte të fliste -nxirrte zë- ky “hekur”.

Për shembull: Mësoi se valët elektromagnetike që shkaktohen si pasojë e lëvizjes së elektroneve nëpër rrymën alternative, përplaseshin në një disk metalik brenda radios, “hekurit që flet”, përmënyrën se kështu vibracione zanore... etj etj.

Por nëse ai do t’ia thoshte popullit të vet atje në malësinë e thellë këto fjalë, si do të reagonin dhe çfarë do të kuptionin ata? Sigurisht që populli i tij nuk do të arrinte të imaginonte dhe kuptione asgjë nga këto fjalë, madje të tilla fjalë mund t’i bënin ata të dyshonin përmënyrën mendore të bashkëfshatarit të tyre, prandaj shumica e tyre nuk do t’i besonin si të vërteta këto fjalë.

Nisur nga sa thamë, përshkrimi me të cilin malësori ia përshkroi radion popullit të tij ishte

përshkrimi më i mençur. Ai me fjalë të përgjithshme dhe të kuptueshme i mësoi popullit të vet një të vërtetë nga të vërtetat që ai pa me sytë e vet.

Në fakt ata që gabuan ishin banorët e fshatit të tij që këmbëngulën ta kuptionin medoemos mënyrën e të folurit të “hekurit që fliste” dhe u zhytën edhe më tepër në gabim kur u bazuan për këtë gjë tek kush kishte karakteristikën e këtij hekuri -tek kush fliste- në mjedisin ku ata jetonin.

E krahasuan hekurin që fliste me njeriun dhe si rezultat i këtij krahasimi të pa arsyeshëm u larguan nga realiteti i radios dhe e imagjinuan atë një njeri prej hekuri me gjuhë, gojë, etj.

Pastaj pasi arritën në këtë mendim të gabuar pyetën njëri-tjetrin: A thua mund të ketë me të vërtetë ndonjë njeri prej hekuri? Dhe u përgjigjën: As që kemi dëgjuar dhe as mendja nuk e pranon një gjë të tillë... Sepse ata e dinin se në mes njeriut dhe hekurit ka një ndryshim të madh si gjaku, mishi, kockat etj. Kështu u detyruan ta përgënjeshtronin fjalën e bashkëfshatarit të tyre megjithëse ai s'i kishte gënjer asnjëherë gjatë gjithë jetës së vet.

Kurse disa të tjerë, nisur nga sinqeriteti i bashkëfshatarit të tyre nuk e përgënjeshtruan direkt atë që u tha ai, por i deformuan fjalët e tij dhe i komentuan ato larg domethënies me të cilën i tha folësi i tyre. Thanë: Ajo që kishte për qëllim të thoshte bashkëfshatari ynë me fjalën e tij se kishte parë një “hekur që fliste” është se ky hekur dukej sikur fliste, por që një hekur të flas s’është e vërtetë dhe as bashkëfshatari ynë nuk kishte për qëllim një gjë të tillë...

A thua se bashkëfshatari i tyre i sinqertë nuk kishte mundësi t'u thoshte atyre se kishte parë një hekur që dukej sikur fliste, gjë që nuk ishte aspak e çuditshme, porse çudia qëndronte në faktin se ai kishte parë një hekur që fliste.

Kështu -duke ndjekur këtë metodë të gabuar të konkluduari- u larguan këto dy grupe nga realiteti i asaj që u tha atyre bashkëfshatari i tyre dhe madje arritën deri aty saqë ca e përgënjeshtuan dhe ca e deformuan tërësisht fjalën e tij...

Por sikur ta kishin pranuar fjalën që u tha bashkëfshatari i tyre, pa u munduar për të depërtuar tek ky sekret me mendjet e tyre të paafta, atëherë edhe do të kishin mësuar një të vërtetë, edhe bashkëfshatarin e tyre nuk do ta kishin cilësuar padrejtësisht si gënjeshtar...

Në fakt ky është gabimi në të cilin bie kushdo që kërkon të kuptojë dhe dijë si-në e cilësive të përsosura dhe të mahnitshme të Allahut të Lartësuar -që për neve janë cilësi të pakonceptueshme dhe të fshehta- duke u referuar për këtë gjë tek cilësitë me të njëjtin emërtim të krijesave që shikojmë.

Referimi në fjalë s'ka dyshim se është një referim dhe krahasim i gabuar, sepse siç e parapërmendëm edhe radioja flet edhe njeriu flet, porse cilësia e të folurit tek ata të dy ndodh në mënyra të ndryshme dhe të përshtatshme me natyrën e çdonjërit prej tyre.

Forca imagjinuese dhe kufizimi i saj me pesë shqisat.

Tentativa dhe përpjekja për të shëmbelluar dhe kuptuar si-në e çështjeve që kanë të bëjnë me botën e fshehtë -të pakapshme për shqisat- mund të bëhet vetëm nëpërmjet forcës imagjinare, mendjes, që është e kufizuar në pesë dritaret e kufizuara të shqisave, më kryesorja e të cilave -në rastin e imagjinimit- është shqisa e të parit.

Prandaj kur mendja përpinqet të imagjinojë ndonjë gjë që ka të bëjë me botën e fshehtësisë -ekzistencën që është e pakapëshme për shqisat- nuk bën gjë tjetër veçse ndërthur ose zbërthen pamjet dhe ndjenjat e tjera që ka parë e ndjerë në këtë botë deri në çastin e këtij imagjinimi.

Kurse për imazhet që nuk ka ku të referohet imagjinata është e paaftë të funksionojë.

Kështu për shembull imagjinata është e paaftë ta imagjinojë personin që i ka rënë ziles së derës dhe ndodhet pas kësaj dere.

Kur dikush i bie ziles së derës, mendja jonë arrin të mësojë se një person i ka rënë ziles porse imagjinata jonë është e paaftë të depërtojë përtej pengesës derë, prandaj ajo nuk e njeh me siguri imazhin apo pamjen e vërtetë të personit që i ka rënë ziles dhe nuk di asgjë nga cilësitë e tij fizike e morale...

E njëjtë gjë ndodh me mendjen në lidhje me dukurinë e gjumit ku njeriu kalon rreth $\frac{1}{3}$ e jetës së tij. Mendja e di se njeriu fle gjumë, porse imagjinata është e paaftë të kuptojë gjë në lidhje me si-në dhe realitetin

e gjumit, megjithëse gjumi është një realitet i pamohueshëm që ka të bëjë drejtëpërsëdrejti me njeriun.

Po kështu mendja jonë ka arritur ta mësojë me bindje dhe argumente ekzistencën e Allahut dhe cilësive të Tij, porse imagjinata jonë është e paaftë ta përfshijë në sferën e konceptimit dhe kuptimit të saj Allahun dhe cilësitë e Tij.

Për ta shpjeguar edhe më qartë kufizimin e forcës imagjinare vëtëm në gjërat që kanë kapur dhe konceptuar shqisat, po japim shembullin në vijim që titullohet “I verbëri dhe koka e gjelit”:

Tregohet se njëherë ndodhi që një i verbër të shikojë për një çast të vetëm dhe ajo ç’ka shikoi ishte një kokë gjeli. Pas kësaj u verbua sërisht. Kështu pra, ky njeri nuk dinte dhe nuk kishte parë në këtë ekzistencë ndonjë gjë tjetër përveç kokës së gjelit. Prandaj kur ndodhë që dikush t’i tregonë atij për ushqimin, i verbëri e pyeste dhe i thoshte: Si është ky ushqimi në krahasim me kokën e gjelit? Po t’i tregonin për shtëpitë, vilat apo pallatet thoshte: Si është kjo shtëpi në krahasim me kokën e gjelit? Po t’i tregonin për rrrobat thoshte: Si janë në krahasim me kokën e gjelit? Po t’i tregonin për makinat, trenat dhe metrotë thoshte: Si janë ato në krahasim me kokën e gjelit? Po t’i tregonin për ndonjë bimë, kafshë, mal, yll... etj thoshte: Si është në krahasim me kokën e gjelit?...

Sepse ai nuk kishte ku ta referonte imagjinatën përveçse në kokën e gjelit që e kishte fiksuar në kujtesën e tij...

Po kështu edhe bota ku depërtojnë shqisat e njeriut është “koka e gjelit” që ka në imagjinatën dhe kujtesën e tij njeriu dhe sa herë që njeriu mundohet të imagjinojë diçka që i përket çështjeve të fshehta që nuk mund t’i konceptojnë shqisat e njeriut -si për shembull- Allahun dhe Cilësitë e Tij-, në imagjinatën e njeriut s’ka ç’të dalë tjetër gjë përveç “kokës së gjelit”.

I tillë -si i verbëri në shembullin e mësipërm-është çdo person që kur dëgjon për cilësitë e përsosura dhe të mahnitëshme të Allahut, mundohet të gjejë se si janë këto cilësi në krahasim me “kokën e gjelit”, prabotën e kapshme dhe të perceptueshme nga shqisat njerëzore.

Dhe të tillë të mjerë janë të gjithë ata që vendosin në imagjinatën e tyre pamje ose figura për Krijuesin dhe cilësitë e Tij, ndërkoq që dihet fare mirë se çështja e Allahut dhe cilësive të Tij të përsosura është një çështje e fshehtë dhe e pakonceptueshme për shqisat, kur dihet se Krijuesi nuk mund dhe s'është e drejtë të krahasohet dhe shëmbellehet me asnjë prej krijesave të Tij, sepse Ai Vetë e ka përshkruar Vetveten e Tij në Kur'anin Fisnik se: “...*Asgjë nuk i përngjan Atij - Allahut- (asgjë nuk është si Ai)...*”

Esh-Shura-Konsulta (11)

Cilësitë dhe emrat e bukur dhe të përsosur të Allahut.

Pas gjithë asaj që thamë, arritëm në përfundimin e përkrahur dhe argumentuar nga Kurani dhe logjika e shëndoshë se ne duhet të besojmë në cilësitë dhe emrat e përsosur të Allahut ashtu siç përmenden në mesazhin hyjnor, pa u munduar ta kuptojmë si-në e tyre, pa i krahasuar, pa i shëmbellyer, pa i deformuar dhe pa i mohuar ato.

Mesazhi hyjnor na tregon se Allahu i Lartësuar posedon cilësitë dhe emrat më të bukur dhe më të përsosur.

Ai ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Kush i mëson ato përmendësh, i kupton drejtë dhe vepron sipas tyre, hyn në Xhenet.

Besimtarët muslimanë i kanë gjetur këto emra në mesazhin hyjnor Islam, në Kur'an dhe në thëniet profetike.

Allahu i Lartësuar në lidhje me cilësitë dhe emrat e Tij të bukur dhe të përsosur thotë në Kuranin Fisnik: **"Allahu ka emrat më të mirë** (dhe më të përsosur) **prandaj** (ju o njerëz të arsyeshëm) **thirreni** (luteni dhe adhurojeni) **Atë me ato** (emra të përsosur që përmenden në mesazhin hyjnor) **dhe distancohuni nga ata që i deformojnë** (mohojnë ose shtrembërojnë larg së vërtetës) **emrat e Tij.**" El-Earaf (180)

Prej këtyre emrave të bukur e të përsosur të Allahut janë edhe emrat: Ekzistuesi, i Gjalli, i Përherëshmi, i Gjithdijskës, i Urti, Furnizuesi, Ushqyesi, Udhëzuesi, Mbrojtësi, i Vetmi, Jetëdhënësi, Jetëmarrësi etj.

Dhe së fundi shprehim falenderimin tonë të thellë për Allahun, Zotin e botërave.